

Nga Arkivi tek Dija - Ndërtimi i Studimeve mbi Sigurimin e Shtetit në Shqipëri

-Fjalë hapëse në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Aspekte të përndjekjes politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar (1944–1991)", 29-30 qershor 2026

Nga Dr. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH

I. PSE JEMI SOT KËTU?

Të nderuar kolegë,

Të nderuar studiues,

Të nderuar ish-të përndjekur politikë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve,

Të dashur miq,

Sikurse edhe ju, pas pothuajse dhjetë vitesh që merrem me studimin e Sigurimit të Shtetit, kam ende një pyetje të thjeshtë: Çfarë është Sigurimi i Shtetit?

Për shumicën e shqiptarëve, përgjigjja është e menjëhershme: një institucion represiv; një instrument i diktaturës; një simbol i frikës. Të gjitha këto janë të vërteta.

Por, për ne që merremi me kërkimin shkencor, kjo përgjigje nuk mjafton. Pyetjet që na shtyn historia të bëjmë janë shumë më të ndërlikuara.

Si funksiononte ky institucion? Si organizohej? Si prodhonte informacion? Si e ndërtonte kategorinë e "armikut"? Si e krijonte rrjetin e bashkëpunimit? Si ndikonte në jetën e përditshme? Dhe, mbi të gjitha, si mund ta studiojmë sot me rigozitet shkencor? Si mund t'ia shpjegojmë këtë publikut? Po brezave të rinj?

Pikërisht këtu fillon edhe arsyeja e kësaj konference.

Ne nuk jemi mbledhur sot vetëm për të kujtuar apo për të dëshmuar. Jemi mbledhur për të kuptuar. Sepse shoqëria demokratike nuk ka nevojë vetëm për kujtesë; ajo ka nevojë edhe për dije.

Dija nuk lind vetvetiu. Ajo ndërtohet përmes kërkimit, analizës dhe interpretimit shkencor. Kërkimi i mirë nuk mjaftohet me përgjigje sipërfaqësore; ai kërkon të depërtojë më thellë, duke iu përgjigjur vazhdimisht pyetjes "pse?". Ky proces kërkon burime, burimet kërkojnë metodë, ndërsa metodat, paradigmat, analizat dhe përfundimet kërkojnë debat.

Prandaj kjo konferencë nuk është vetëm një aktivitet shkencor. Ajo është një forum ku lindin pyetje të reja, sfidohen qasje të vjetra dhe merr formë një fushë kërkimore që në Shqipëri është ende në zhvillim: studimet mbi Sigurimin e Shtetit gjatë diktaturës komuniste.

II. SI LINDI NË BOTË KJO FUSHË STUDIMI?

Nëse do të ktheheshim pas në kohë, do të shihnim se, për shumë dekada, studiuesit nuk i trajtonin policinë sekrete si një objekt studimi më vete. Vëmendja e tyre përqendrohej kryesisht te natyra e regjimeve totalitare.

Në vitin 1951, Hannah Arendt botoi veprën monumentale “The Origins of Totalitarianism”, duke argumentuar se terrori nuk ishte një devijim i pushtetit, por vetë mënyra e funksionimit të tij.

Pak vite më vonë, Carl J. Friedrich dhe Zbigniew Brzezinski, në veprën “Totalitarian Dictatorship and Autocracy” (1956), përshkruan karakteristikat institucionale të shtetit totalitar, duke e vendosur policinë sekrete në zemër të sistemit politik.

Për afro katër dekada, ky ishte debati mbizotërues. Pas shembjes së regjimit nazist dhe zbulimit të përmasave të terrorit stalinist, pyetja themelore që shtrohej ishte: Çfarë është totalitarizmi?

Por, pas rënies së Murit të Berlinit dhe hapjes së arkivave në Europën Qendrore dhe Lindore, panorama ndryshoi rrënjësisht. Për herë të parë, studiuesit patën mundësi të lexonin dokumentet e KGB-së, të Stasit, të Securitate-s rumune dhe të shërbimeve të tjera sekrete.

Edhe pyetjet ndryshuan. Nga "Çfarë ishte totalitarizmi?" kaluam te "Si funksiononte pushteti?"

Kështu lindi një fushë e re studimore.

Historianë si Christopher Andrew dhe Vasili Mitrokhin analizuan strukturën dhe logjikën institucionale të KGB-së. Historia e arkivit të Mitrokhinit, i cili nxori jashtë Bashkimit Sovjetik mijëra dokumente sekrete, hodhi dritë për herë të parë mbi mekanizmat e inteligjencës sovjetike dhe funksionimin e KGB-së.

Jens Gieseke studioi rrjetet e bashkëpunëtorëve të Stasit.

Robert Gellately hapi një debat të rëndësishëm mbi rolin e denoncimeve dhe të bashkëpunimit shoqëror në funksionimin e regjimeve totalitare.

Në të njëjtën kohë, Sheila Fitzpatrick, J. Arch Getty, Stephen Kotkin dhe Alexei Yurchak e zhvendosën vëmendjen drejt jetës së përditshme, duke treguar se historia e komunizmit nuk mund të kuptohet vetëm përmes terrorit, por edhe përmes mekanizmave të konformizmit, negocimit dhe mbijetesës.

Kjo qasje, e njohur nga disa autorë si shkolla revizioniste, sfidoi interpretimin klasik të totalitarizmit të përfaqësuar nga Hannah Arendt dhe autorët që ndoqën këtë traditë.

Një zhvillim po aq i rëndësishëm erdhi nga antropologjia dhe studimet mbi arkivat.

Katherine Verdery, duke analizuar dosjen e saj personale të hartuar nga Securitate, dhe Ann Laura Stoler, me konceptin tashmë të njohur “reading along the archival grain”, na kujtuan se dokumenti nuk është kurrë neutral.

Ai është vetë produkt i pushtetit.

Në këtë traditë vendosen edhe reflektimet e Michel Foucault mbi marrëdhënien ndërmjet pushtetit dhe dijes, si edhe ato të Jacques Derrida, i cili në veprën “Archive Fever” (1995) argumenton se arkivi nuk ruan thjesht të kaluarën, por prodhon autoritet dhe formëson kujtesën.

Në dy dekadat e fundit, kësaj fushe iu bashkuan edhe studimet mbi kujtesën kolektive dhe drejtësinë tranzicionale.

Timothy Garton Ash, Aleida Assmann, Jan Assmann, Ruti Teitel, Priscilla Hayner dhe Martha Minow treguan se arkivat nuk kanë vetëm funksion historik.

Ato janë edhe instrumente të së drejtës për të vërtetën, të rehabilitimit të viktimave dhe të ndërtimit të demokracisë.

Sot, studimet mbi policitë sekrete përbëjnë një fushë ndërdisiplinore ku bashkëpunojnë historianë, antropologë, sociologë, juristë, studiues të kujtesës, specialistë të arkivave dhe, së fundmi, edhe ekspertë të humaniteteve digjitale dhe të inteligjencës artificiale.

Pikërisht në këtë traditë ndërkombëtare të studimit të policive sekrete fillon të pozicionohet gradualisht edhe kërkimi shqiptar mbi Sigurimin e Shtetit.

Kjo është fusha në të cilën edhe Shqipëria po fillon të japë kontributin e saj.

III. EKOSISTEMI SHQIPTAR I KUJTESËS: NGA DËSHMIA TEK KËRKIMI SHKENCOR

Edhe Shqipëria ka ndjekur rrugën e saj. Një rrugë më të vonshme, më të vështirë, por njëkohësisht shumë të veçantë.

Sot besoj se mund të flasim për ekzistencën e një ekosistemi shqiptar të kujtesës. Një ekosistem ku bashkëjetojnë arkivat, dëshmitë, studiuesit, universitetet, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, familjet dhe vetë qytetarët.

Ndërsa në Europë zhvilloheshin teoritë mbi totalitarizmin dhe mekanizmat e tij, në Shqipëri regjimi komunist vijonte të mbetej një nga format më të mbyllura të stalinizmit. Në këto rrethana, zhvillimi i një mendimi kritik ishte pothuajse i pamundur.

Megjithatë, edhe në kushtet e censurës dhe të represionit, nuk u ndërpre krejtësisht krijimtaria që dokumentonte përvojën e përndjekjes politike. Veprat e Arshi Pipës, Fatos Lubonjës, Uran Kostreçit, Lazër Radit, Drita Çomos dhe shumë autorëve të tjerë ruajtën një kujtesë alternative, edhe kur një pjesë e tyre nuk mundi të botohej në kohën kur u shkrua.

Në diasporë, kjo traditë u mbajt gjallë nga revista “Shejzat” e Ernest Koliqit, nga veprimtaria intelektuale e Arshi Pipës, nga botimet e Bilal Xhaferrit dhe nga autorë të tjerë që sfiduan versionin zyrtar të historisë shqiptare.

Brenda vendit, Ismail Kadare, përmes një gjuhe alegorike dhe simbolike, arriti të depërtojë kufijtë e censurës, duke ndërtuar në vepra si “Pallati i Ëndrrave” një reflektim të thellë mbi mekanizmat e pushtetit totalitar.

Në këndvështrimin tim, ky ekosistem i kujtesës është ndërtuar gradualisht, duke kaluar në katër faza.

Faza e parë: çlirimi i kujtesës

Faza e parë fillon pas vitit 1991 dhe mund të përkufizohet si faza e çlirimit të kujtesës.

Në këtë periudhë dolën në dritë dëshmitë personale, kujtimet e burgjeve dhe internimeve, letërsia e përndjekjes politike dhe reflektimet morale mbi diktaturën.

Autorë si Arshi Pipa, Sami Repishti, Zef Pllumi, Kasëm Trebeshina, Bilal Xhaferri, e më pas Fatos Lubonja, Visar Zhiti, Bashkim Shehu, Shkëlqim Abazi, Saimir Maloku, Ylber Merdani, Naim Pasha dhe shumë të tjerë krijuan korpusin e parë të kujtesës shqiptare mbi komunizmin.

Faza e dytë: institucionalizimi i historiografisë

Faza e dytë lidhet me institucionalizimin e historiografisë mbi periudhën e diktaturës, tashmë në kushtet e lirisë akademike.

Historianë si Beqir Meta, Ana Lalaj, Marenglen Kasmi, Sonila Boçi, Romeo Gurakuqi, Kastriot Dervishi, Nevila Nika, Hasan Bello, Enriketa Papa, Gjon Borici, Artan Puto, Artan Hoxha dhe studiues të tjerë filluan ta analizojnë në mënyrë më sistematike shtetin komunist dhe institucionet e tij.

Në të njëjtën kohë, një brez i ri studiuesish shqiptarë jashtë vendit e vendosi Shqipërinë në debatin ndërkombëtar.

Elidor Mëhilli, me veprën "From Stalin to Mao" (2017), e analizoi Shqipërinë si pjesë të historisë së botës socialiste.

Idrit Idrizi, përmes studimeve mbi jetën e përditshme në socializmin e vonë shqiptar, solli për herë të parë në historiografinë shqiptare qasjen e historisë sociale.

Lea Ypi, duke ndërthurur kujtesën personale me analizën filozofike, e lidhi përvojën shqiptare me debatet bashkëkohore mbi kujtesën, lirinë dhe demokracinë.

Në këtë panoramë duhen përmendur edhe "Enciklopedia e Viktimave të Komunizmit" e botuar nga ISKK, botimet e Agron Tufës, si dhe studimet e bazuara në dokumente arkivore të Kastriot Dervishit, të cilat kanë zgjeruar ndjeshëm bazën e kërkimit mbi periudhën komuniste.

Faza e tretë: ndërtimi i infrastrukturës së kujtesës

Faza e tretë nis me krijimin e AIDSSH-së dhe, sipas vlerësimit tim, shënon ndërtimin e infrastrukturës kombëtare të kujtesës.

Për herë të parë, Shqipëria krijoi një institucion të specializuar për administrimin, deklasifikimin, studimin dhe vënien në dispozicion të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Studimi i këtyre dokumenteve ka njohur një zhvillim të ndjeshëm. Vetëm gjatë vitit 2025 u vunë në dispozicion të studiuesve dhe qytetarëve rreth një çerek milioni faqesh dokumente arkivore.

Në të njëjtën kohë janë organizuar konferenca ndërkombëtare, simpoziume shkencore dhe botime tematike mbi sistemin e kampeve dhe burgjeve, profilin e "armikut të popullit", emigracionin politik, kufirin, industrinë e naftës, Kosovën dhe tema të tjera të historisë së diktaturës.

Botime si dosjet e ndjekjes së Maks Velos dhe Mit'hat Havarit, të shoqëruara me aparatit kritik dhe shënime biografike, dëshmojnë një qasje të re në përdorimin shkencor të dokumentacionit arkivor.

Në të njëjtën frymë mund të përmenden edhe botimet e Jozef Radit, kushtuar dosjeve të Beqir Sinës dhe figurave të tjera të historisë shqiptare.

Faza e katërt: nga dokumenti te dija

Sot besoj se po hyjmë në fazën e katërt.

Nga leximi drejt kërkimit.

Nga dokumenti drejt metodës.

Nga arkivi drejt dijes.

Kjo është faza në të cilën studimet mbi Sigurimin e Shtetit po marrin gradualisht formën e një fushe të mirëfilltë akademike.

Dhe kjo konferencë është pjesë e këtij rrugëtimi.

Ajo nuk është fundi i një procesi.

Është fillimi i një kapitulli të ri.

IV. NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS SHQIPTARE TË KUJTESËS DHE KËRKIMIT

Nëse sot mund të flasim për zhvillimin e studimeve mbi Sigurimin e Shtetit në Shqipëri, kjo nuk ndodh vetëm sepse kemi më shumë studiues apo një interes më të madh akademik.

Kjo është e mundur sepse, për herë të parë, po ndërtohet infrastruktura mbi të cilën mund të mbështetet kërkimi shkencor. Historia e shekullit XX tregon se çdo traditë e konsoliduar kërkimore ka lindur pasi është krijuar më parë infrastruktura që e bën të mundur kërkimin: arkivat, bibliotekat, standardet profesionale dhe komuniteti shkencor.

Asnjë shkollë studimore nuk lind pa burime.

Asnjë studiues nuk mund të punojë pa dokumente.

Asnjë debat serioz nuk mund të zhvillohet pa akses në arkiva.

Prandaj, një nga misionet kryesore të Autoritetit gjatë këtyre viteve ka qenë pikërisht ndërtimi i kësaj infrastrukture.

Në radhë të parë, përmes administrimit, sistemimit, përshkrimit arkivor, deklasifikimit dhe anonimizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit.

Në të njëjtën kohë është punuar për dixhitalizimin e fondeve arkivore, standardizimin e përshkrimit arkivor dhe krijimin e kushteve që dokumenti të mos mbetet vetëm objekt ruajtjeje, por të shndërrohet në objekt studimi.

Por infrastruktura kërkimore nuk ndërtohet vetëm me arkiva.

Ajo ndërtohet edhe me botime.

Edhe me platforma.

Edhe me biblioteka.

Edhe me komunitete studiuesish.

Për këtë arsye, AIDSSH ka zhvilluar një program të gjerë botimesh dokumentare dhe studimore.

Seria "Kur Sigurimi merrej me shkence." ka sjellë në vëmendje ndërhyrjen e Sigurimit të Shtetit në fusha të ndryshme të jetës shqiptare.

Botime si "E Majta e përndjekur" dhe vëllime të tjera dokumentare nuk synojnë vetëm të publikojnë dokumente arkivore. Ato përpiqen të rindërtojnë fatet e individëve dhe të grupeve shoqërore, duke zbuluar njëkohësisht mekanizmat dhe mënyrën e funksionimit të Sigurimit të Shtetit.

Në këtë mënyrë, dokumenti nuk paraqitet si një burim i izoluar, por si pjesë e një konteksti historik dhe institucional më të gjerë.

Këto botime nuk kanë si synim vetëm të shtojnë fondin dokumentar në dispozicion të studiuesve.

Ato synojnë të nxisin pyetje të reja kërkimore, të hapin drejtime të reja studimi dhe të krijojnë mundësi për analiza më të thelluara.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti po punon për krijimin e revistës së tij shkencore, si dhe për botimin sistematik të akteve të konferencave shkencore.

Këto iniciativa synojnë të krijojnë një hapësirë të qëndrueshme ku studiuesit shqiptarë dhe të huaj të mund të publikojnë rezultatet e kërkimeve të tyre, duke e bërë Shqipërinë pjesë të debatit ndërkombëtar mbi policitë sekrete, kujtesën historike dhe drejtësinë tranzicionale.

Kjo është një infrastrukturë që nuk ndërtohet për një institucion.

Ajo ndërtohet për një komunitet shkencor.

Dhe, mbi të gjitha, ndërtohet për brezat që do të vijnë.

V. NGA DOKUMENTI TEK NJERIU: DËSHMITË E GJALLA DHE KUJTESA SHOQËRORE

Megjithatë, arkivi nuk flet kurrë i vetëm.

Çdo dokument bart këndvështrimin e institucionit që e ka prodhuar.

Dosja e Sigurimit është një dokument i shtetit.

Ajo nuk përfaqëson të vërtetën e plotë.

Ajo na tregon se si shteti e shihte individin; jo domosdoshmërisht se kush ishte ai në të vërtetë.

Pikërisht për këtë arsye, që në fillim të veprimtarisë së tij, Autoriteti investoi në ndërtimin e një arkivi tjetër: arkivit të kujtesës njerëzore.

Programi "Dëshmitë e Gjalla" është ndërtuar mbi bindjen se historia nuk mund të shkruhet vetëm përmes dokumenteve burokratike.

Deri më sot janë mbledhur mbi 160 dëshmi audio dhe video të ish-të përndjekurve politikë, familjarëve të tyre dhe dëshmitarëve të ngjarjeve.

Por rëndësi nuk ka vetëm numri.

Rëndësi ka metoda.

Çdo intervistë paraprihet nga studimi i dosjes arkivore, dokumentacionit administrativ dhe literaturës ekzistuese.

Intervistat zhvillohen sipas një protokollit gjysmë të strukturuar, regjistrohen në audio dhe video, transkribohen, indeksohen dhe ruhen sipas standardeve bashkëkohore arkivore.

Në këtë mënyrë, dëshmia nuk mbetet vetëm një rrëfim personal.

Ajo shndërrohet në një burim kërkimor.

Ky është edhe një nga kontributet metodologjike që, sipas bindjes sime, AIDSSH ka sjellë në studimet shqiptare mbi komunizmin.

Ne nuk e vendosim dokumentin përballë dëshmisë.

Ne propozojmë që ato të lexohen së bashku.

Dosja.

Dëshmia.

Dokumenti personal.

Fotografia.

Ditari.

Korrespondenca.

Burimet gjyqësore.

Vetëm dialogu ndërmjet këtyre burimeve na afron më shumë me të vërtetën historike.

Ky është parimi i ‘triangulimit të burimeve’, një metodë që sot konsiderohet standard në studimet ndërkombëtare mbi policitë sekrete dhe që ne përpiqemi ta zbatojmë sistematikisht edhe në Shqipëri.

Në të njëjtën frymë është ndërtuar edhe Biblioteka "Musine Kokalari".

Sot ajo përmban mbi 650 tituj të specializuar dhe është biblioteka më e pasur në Shqipëri e dedikuar studimeve mbi komunizmin, policitë sekrete, të drejtat e njeriut, drejtësinë tranzicionale, historinë gojore dhe kujtesën kolektive.

Një pjesë e rëndësishme e këtij fondi përbëhet nga botime universitare, libra të rrallë, botime të huaja me tirazh të kufizuar dhe vepra që nuk ribotohen më.

Ambicia jonë është që kjo bibliotekë të mos jetë vetëm një hapësirë leximi.

Ajo synon të bëhet një qendër kombëtare burimesh për çdo studiues shqiptar apo të huaj që dëshiron të kuptojë historinë e komunizmit shqiptar në dialog me përvojën europiane.

VI. Kjo konferencë: Jo një pikë mbërritjeje, por një pikë nisjeje

Të dashur kolegë,

Çdo konferencë është një moment reflektimi.

Por disa konferenca bëhen edhe pika kthese.

Besoj se konferenca jonë synon të jetë pikërisht një moment i tillë.

Jo sepse do të japë përgjigje përfundimtare.

Përkundrazi.

Sepse do të ngrejë pyetje të reja.

Do të sfidojë qasje të vjetra.

Do të krijojë bashkëpunime të reja.

Do të hapë burime që deri dje nuk ishin përdorur në kërkim.

Dhe, mbi të gjitha, do të afrojë njerëz që e shohin të kaluarën jo si një fushë ndarjeje, por si një fushë kërkimi, reflektimi dhe emancipimi intelektual.

Në shumë vende europiane, studimet mbi policitë sekrete kanë kaluar tashmë nga faza e dokumentimit në fazën e analizës.

Nga historia institucionale drejt historisë sociale.

Nga historia politike drejt antropologjisë së pushtetit.

Nga arkivi si depo dokumentesh drejt arkivit si objekt studimi në tërësinë e tij: në gjuhën që përdor, në mënyrën si prodhon kategori, në marrëdhëniet që ndërton dhe në logjikën institucionale që pasqyron.

Edhe Shqipëria ka filluar ta ndjekë këtë rrugë.

Ne e kemi kaluar fazën kur pyetja kryesore ishte nëse arkivat duhej të hapeshin.

Sot pyetjet janë shumë më ambicioze.

Si t'i lexojmë ato?

Si të ndërtojmë metodologji kërkimi?

Si t'i krahasojmë me përvojat europiane?

Si ta vendosim rastin shqiptar në historiografinë ndërkombëtare të studimeve mbi policitë sekrete?

Kjo konferencë është një hap në këtë drejtim.

Jo si një aktivitet i izoluar.

Por si pjesë e një procesi afatgjatë që synon krijimin e një komuniteti kërkimor shqiptar mbi Sigurimin e Shtetit.

Besoj se studimet mbi Sigurimin e Shtetit do të zënë, në vitet që vijnë, një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në historiografinë shqiptare.

Sepse ato nuk lidhen vetëm me të shkuarën.

Ato lidhen me mënyrën se si funksionon pushteti.

Me marrëdhënien ndërmjet shtetit dhe qytetarit.

Me prodhimin e informacionit.

Me kontrollin shoqëror.

Me lirinë.

Me dinjitetin njerëzor.

Me të drejtat e njeriut.

Për këtë arsye, kjo nuk është një fushë që u përket vetëm historianëve.

Ajo kërkon bashkëpunimin e juristëve, sociologëve, antropologëve, arkivistëve, studiuesve të shkencave politike, specialistëve të historisë gojore, si edhe ekspertëve të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale.

Vetëm një qasje e tillë ndërdisiplinore mund të na japë një kuptim më të plotë të mekanizmave të diktaturës dhe të trashëgimisë së saj në shoqërinë demokratike.

Prandaj dëshiroj që kjo konferencë të mos mbetet vetëm një takim i përvitshëm.

Uroj që ajo të shndërrohet në një forum të përhershëm shkencor.

Në një hapësirë ku studiuesit shqiptarë dhe të huaj të debatojnë, të kundërshtojnë njëri-tjetrin me argumente, të ndërtojnë metoda të reja dhe të krijojnë projekte të përbashkëta kërkimore.

Sepse shkenca nuk përparon kur të gjithë bien dakord.

Ajo përparon kur argumentet provohen, sfidohen dhe përmirësohen.

Në fund të fundit, studimi i Sigurimit të Shtetit nuk ka për qëllim vetëm të kuptojë një institucion të së kaluarës. Ai synon të kuptojë se si ndërtohen mekanizmat e kontrollit, si prodhohet frika dhe si mbrohen liria dhe dinjiteti në një shoqëri demokratike.

VII. INFRASTRUKTURA MË E RËNDËSISHME NUK JANË VETËM DOKUMENTET. JANË NJERËZIT QË PUNOJNË ME TO.

Shpesh, kur flasim për arkivat, mendojmë për raftet, dosjet apo dokumentet.

Por arkivat nuk prodhojnë dije vetvetiu.

Dija ndërtohet nga njerëzit që i lexojnë, i interpretojnë dhe i vendosin në dialog me burime të tjera.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme të këtyre viteve ka qenë pikërisht krijimi i një komuniteti profesional brenda AIDSSH-së.

Sot, pjesa dërrmuese e stafit të Autoritetit ka formim të avancuar universitar, me studime të nivelit master dhe doktoraturë në fusha të ndryshme.

Kjo shumëllojshmëri nuk është rastësi.

Ajo është një domosdoshmëri metodologjike.

Sepse studimi i Sigurimit të Shtetit është, në vetvete, një fushë ndërdisiplinore.

Arkivisti sjell njohjen e proveniencës së dokumentit, autenticitetit të tij, organizimit të fondit dhe kontekstit në të cilin është prodhuar. Ai ndihmon të kuptohet se si ka lindur dokumenti dhe çfarë vendi zë ai në sistemin arkivor.

Juristi sjell analizën e legjislacionit të kohës, të standardeve të të drejtave të njeriut, të drejtësisë tranzicionale dhe të së drejtës për të vërtetën. Ai ndihmon në interpretimin e dokumentit në raport me shtetin e së drejtës.

Historiani e vendos dokumentin në kontekstin politik, shoqëror dhe ndërkombëtar. Ai kërkon të shpjegojë jo vetëm çfarë ndodhi, por edhe pse ndodhi.

Specialisti i historisë gojore, sociologu, antropologu, psikologu apo gazetari e ballafaqon dokumentin me përvojën njerëzore, kujtesën individuale dhe kujtesën kolektive.

Specialisti i teknologjisë dhe i dixhitalizimit krijon kushtet që dokumenti të jetë i aksesueshëm, i kërkueshëm dhe i përdorshëm për brezat e ardhshëm.

Specialisti i edukimit qytetar e shndërron rezultatin e kërkimit në dije të transmetueshme për të rinjtë.

Ndërsa specialistët e komunikimit dhe të botimeve e bëjnë këtë dije pjesë të debatit publik.

Vetëm kur të gjitha këto perspektiva bashkohen, dokumenti arkivor shndërrohet në njohuri shkencore.

Prandaj, një nga arritjet më të rëndësishme të AIDSSH-së nuk është vetëm administrimi i arkivit.

Është ndërtimi i një kulture profesionale të dialogut.

Ne debatojmë çdo ditë.

Debatojmë mbi metodën.

Mbi kufijtë e dokumentit.

Mbi etikën e publikimit.

Mbi mënyrën se si lexohet një dosje.

Sepse kërkimi shkencor nuk përparon në mungesë të debatit.

Përkundrazi.

Ai përparon kur profesionistë me formime të ndryshme sfidojnë njëri-tjetrin me argumente, burime dhe metodë.

Ky është modeli që ne kemi zgjedhur të ndërtojmë.

Jo një institucion ku dokumentet vetëm ruhen.

Por një institucion ku dokumentet lexohen, diskutohen, analizohen dhe kthehen në dije.

Le të shpresojmë që kjo konferencë të jetë edhe një hap tjetër në ndërtimin e një shkolle shqiptare të studimeve mbi Sigurimin e Shtetit: një shkollë e hapur ndaj dialogut ndërkombëtar, e mbështetur mbi standardet e kërkimit shkencor dhe e udhëhequr nga respekti për të vërtetën, dinjitetin njerëzor dhe kujtesën demokratike. Sepse vetëm kur arkivi shndërrohet në dije, kujtesa shndërrohet në përgjegjësi demokratike.

Ju faleminderit!

